

## SKEMA E VLERËSIMIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2017

1. Është rrethuar numri 2. kanë frikë nga gjithçka që është e panjohur dhe ndryshe - **1 pikë**
2. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse shkruan: *Vilemina*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon JO dhe shkruan: Vinsenti është piktor/artist i mirë, por dëshiron të vizatojë sa më bukur, kërkon të jetë i përkryer (dhe përgjigje të tjera të sakta)  
(Vërejtje: nxënësi merr **1 pikë** nëse nuk e ka rrethuar përgjigjen PO, por ka dhënë arsyetimin e saktë.  
Nëse ka rrethuar PO, por nuk ka dhënë arsyetimin e saktë ose nuk e ka shkruar fare arsyetimin merr – **0 pikë**)
4. Është rrethuar numri 2. Nuk kam sukses, sepse vizatoj ashtu siç i përjetoj unë gjërat - **1 pikë**
5. A) Është rrethuar numri 1 – kënaqësinë – **1 pikë**  
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: “*Po në goftë se ai person ndihet i lumtur falë atij arti të keq?*” (dhe përgjigje tjera të sakta)
6. Është rrethuar numri 2 – habi - **1 pikë**
7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: “*Arti nuk respekton rregulla, kërkon të bukurën, lirinë artistike; teologjia kërkon respektimin e rregullave të ashpra, kërkon pagabueshmërinë...* (dhe përgjigje tjera të sakta)  
  
Po të jetë përgjigjja më e plotë dhe stilistikisht më e realizuar nxënësi merr **2 pikë**.
8. Është rrethuar numri 3 - *Donte të dinte kush ishte ai njeri që nuk kishte ardhur për t’i uruar sukses para nisjes në luftë.* - **1 pikë**
9. Është rrethuar numri 2 – indiferencë dhe krenari - **1 pikë**
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: “Aleksandri dëshiron të tregojë se e vlerëson Diogjenin dhe qëndrimin e tij/ Aleksandri tregon respekt për Diogjenin dhe të drejtën e tij që të mos i përkulet me çdo kusht vullnetit të dikujt tjetër “ (dhe përgjigje tjera të sakta)

\* Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

11. Është rrethuar numri 3 – dramë e absurdit – **1 pikë**

12. Nxënësi merr **2 pikë** nëse jep *përgjigje krejtësisht të saktë (rrethon saktë dhe jep arsyetimin e përgjigjes):*

ELEMENT I DRAMËS	PO	JO	ARSYETIMI I PËRGJIGJES
skena	PO	JO	Është dhënë përshkrimi – rruga fushore, një dru, mbrëmje; përshkruhet çfarë bëjnë personazhet. (dhe përgjigje tjera të sakta).
ngjarja	PO	JO	Nuk ka ngjarje, asgjë nuk ndodh ose gjithçka është rrudhur në disa lëvizje. (dhe përgjigje tjera të sakta).
konflikti	PO	JO	Konflikti mungon, protagonistët e dramës heshtin ose bisedojnë për gjëra të parëndësishme. (dhe përgjigje tjera të sakta).

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar saktë dhe ka arsyetuar saktë dy elemente të dramës.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar saktë dhe ka arsyetuar vetëm një element të dramës.

13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon përgjigjen PASAKTË dhe shkruan:  
*Besën për të mos u treguar bashkëshorteve për vendimin që kanë marrë e shkelin dy vëllezërit e mëdhenj, kurse e mban vetëm vëllai i vogël.* (dhe përgjigje tjera të sakta).

(Vërejtje: Nxënësi merr një pikë nëse nuk ka rrethuar përgjigjen e duhur, por e ka arsyetuar saktë përgjigjen.

Kur nxënësi e ka rrethuar përgjigjen PASAKTË, por nuk e ka arsyetuar saktë, ose nuk e ka arsyetuar fare përgjigjen, merr **- 0 pikë**)

14. Nxënësi merr **3 pikë** për shpjegimin e plotë të vargjeve të cituara.

**3 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve dhe mostregimi i planit të murosjes së njëres nga gratë dhe mosshembja e kalasë për shkak të flijimit (dhe përgjigje tjera të ngjashme)

**2 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve dhe mostregimi i panit të muroshjes

**1 pikë** Lidhja e besës në mes të vëllezërve

**0 pikë** nëse nxënësi ka dhënë përgjigje të gabuar ose nuk ka dhënë asnjë përgjigjeje

**15.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Mësuesi, shumë i entuziazmuar, i tha se përgjigjja e tij/e saj ishte shumë e saktë.*

**16.** Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen plotësisht të saktë.

shkencave - emër  
ndihmon – folje  
të cilat – përemër  
dhe – lidhëz

**17.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Françesko Petrarca.*

**18.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar dhe sqaruar saktë të paktën dy konstatime.

KONSTATIMI	SAKTË PASAKTË	ARSYETO PËRGJIGJEN
<b>VUAJTJET E DASHURISË është sonet.</b>	<input checked="" type="radio"/> S <input type="radio"/> P	Poezia është sonet sepse është e përbërë nga dy strofa me nga katër vargje dhe dy strofa me nga tre vargje. (pranohet edhe skema e sonetit)
<b>Vjersha ka motiv dashurie.</b>	<input checked="" type="radio"/> S <input type="radio"/> P	Po. Kjo vërehet që në titullin e poezisë dhe në gjithë përmbajtjen e saj (dhe në mënyrë eksplicite në vargun e fundit).
<b>Vjersha transmeton qetësi shpirtërore.</b>	<input type="radio"/> S <input checked="" type="radio"/> P	Jo. Vjersha nuk transmeton qetësi, por një gjendje të turbullt shpirtërore, me vuajtje dhe pasiguri.

19. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: antiteza.

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: figura e antitezës në këtë varg përshkruan gjendjen e turbullt shpirtërore të folësit lirik (autorit, poetit) lidhur me gruan që dashuron. (dhe përgjigje tjera të sakta).

20. Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë.

Përgjigjet e sakta janë:

1. Hamleti
2. Raskolnikovi
3. Dr Adham-Uti

Nxënësi merr **1 pikë** për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një përgjigje të saktë.

21. Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë.

i tyre - rasa gjinore.

qytetit - rasa dhanore

një krusmë – rasa emërore

22. Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë.

Në sallën solemne të Qendrës Kulturore Informativë “Malësia” në Tuz, mbrëmë u organizua prezantimi i librit “Komunikojmë dhe hartojmë përdorimin e gjuhës” të autorit Bahri Beci.

23. A) Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë:

zhvesh ; shpik ; (i,e) lezetshëm

B) Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë:

mashkull - meshkuj

thes - thasë

fyell - fyej

24. Nxënësi merr **2 pikë** për katër përgjigje të sakta (titulli i veprës dhe emri e mbiemri i autorit):

Beatriçja - Komedia hyjnore (Ferri), Dante Aligieri

Vlladika Danillo – Kurora e maleve, Petar II Petroviq Njegosh

Kreonti - Antigona, Sofokliu

Zonja Johansson - Enciklopedia e të vdekurve, Danillo Kish

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar tri përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka shkruar një ose dy përgjigje të sakta.

25. **A)** Nxënësi ka rrethuar përgjigjen pranë numrit 4 – letërsia popullore si frymëzim - **1 pikë**

**B)** Sqarimi pranë numrit katër është veçori e romantizmit, tri sqarimet e tjera kanë të bëjnë me realizmin. – **1 pikë**

26. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigje plotësisht të saktë:

Hektori – tarogzëtundësi

Akili – këmbëshpejti

Andromaka - krahëbardha

27. Nxënësi ka rrethuar numrin 3 – Albert Kamy - **1 pikë**

28. **A)** ekzistencializmi (absurditeti) - **1 pikë**

**B)** Në azil portieri kishte hyrë nga nevoja – **1 pikë**

**C)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

Narratorit i bënte përshtypje mënyra se si ai thoshte “ata”, “të tjerët” dhe më rrallë “pleqtë”, kur fliste për pleqtë e azilit disa, prej të cilëve nuk ishin më të moshuar se ai.

29. Nxënësi merr – **1 pikë** nëse përgjigjet saktë:

Teksti i Hasan Mekulit bën pjesë në letërsinë shkencore/joartistike (kritikë letrare).

(Argumenti: Kjo vërehet nga gjuha e përdorur dhe nga përmbajtja kuptimore e tekstit.) (dhe përgjigje tjera të sakta).

Nëse e ka shkruar edhe argumentin, nxënësi merr **2 pikë**.

### 30. Skema për vlerësimin e esesë: “Koprraci”

<b>Kërkesa 1.</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Nxënësi shkruan se autori është Moliere, ndërsa vepra i përket periudhës së klasicizmit. <b>– 1 pikë</b></li> <li>- Nxënësi shkruan se vepra i përket gjinisë dramatike dhe se është komedi. <b>- 1 pikë</b></li></ul> <p style="text-align: right;"><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 2.</b>	<p>Nxënësi sqaron se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Harpagoni në vepër paraqitet si një koprrac i pasur antipatik <b>- 1 pikë</b></li></ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p> <p style="text-align: right;"><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 3.</b>	<p>Nxënësi shkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- për vesin e koprracisë – <b>1 pikë</b></li><li>- se Harpagoni për shkak të parave humb besimin tek të gjithë – <b>1 pikë</b></li><li>- si ndikon Harpagoni në rrethin shoqëror – <b>1 pikë</b></li><li>- përmes skenave me plot humor kuptojmë se vesi, kur i kalon caqet, bëhet i rrezikshëm. – <b>1 pikë</b></li><li>- se përmes koprracisë së Harpagonit Moliere demaskon veset e shoqërisë dhe pasojat sociale të atij vesi. – <b>1 pikë</b></li></ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p> <p style="text-align: right;"><b>Gjithsej 6 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 4.</b>	<p>Nxënësi shkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- për intrigën që i bën Klearti babait të vet, duke i rrëmbyer arkën e parave me ndihmën e shërbëtorit të vet Shigjetës, me qëllimi për ta shfrytëzuar si “peng” – për ta ndërruar me Marianën. <b>- 1 pikë</b></li></ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p> <p style="text-align: right;"><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>

<b>Kërkesa</b> <b>5.</b>	<p>Nxënësi shkruan se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në tekst Harpagoni shfaqet si dyfytërësh kur tenton ta shfrytëzojë mjerimin e Marianës së re për ta detyruar të martohet me të. <span style="float: right;"><b>- 1 pikë</b></span></li> <li>- Harpagoni megjithëse donte të martohej me Marjanën, i vënë në pozitën “zgjidh e merr”, e lë vajzën dhe në vend të saj merr arkën e parave. <span style="float: right;"><b>- 1 pikë</b></span></li> </ul> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr <b>1 pikë</b></i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>
-----------------------------	--

### Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p>

<p>ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>



	<p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
--	--	--	--

### Skema për vlerësimin e esesë: (Pa)kultura e tifozëve

<p><b>Kërkesa</b> <b>1.</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <p>- shpreh qëndrimin e vet lidhur me sportin, marrjen me sport, mbi atë se njeriu duke u marrë me sport mëson të socializohet, të komunikojë, mbi rivalitetin, të respektojë rregullat dhe kundërshtarin; të zhvillojë shpirtin garues dhe dëshirën për të arritur rezultate të mira. <b>- 1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr <b>1 pikë</b></i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>2.</b></p>	<p>Nxënësi :</p> <p>- shkruan se pa marrë parasysh se është i dobishëm, në sport lajmërohen edhe problemet e vandalizmit dhe të huliganizmit; se mediat gjithnjë e më shumë emetojnë pamje të dhunës në fushat e sportit dhe në shkallët e tifozëve, me ç'rast shkaktohen lëndime të lojtarëve, arbitrave, tifozëve, fëmijëve... <b>- 1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr <b>1 pikë</b></i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>

<p><b>Kërkesa</b> <b>3.</b></p>	<p>Nxënësi :</p> <p>- shkruan se shkaqet e dhunës mund të vijnë nga: përdorimi dhe futja e alkoolit dhe e substancave psiko-aktive; keqpërdorimi i mjeteve piroteknike, mosrespektimi i ligjit, rënia e moralit, niveli i ulët i kulturës së përgjithshme, nacionalizmi, luftërat në rajon, ambiciet e tepruara të prindërve, vendosja e theksit vetëm te rëndësia e fitores, referimi jo adekuat në ndeshje, kurdisja e ndeshjes dhe blerja e rezultatit, mungesa e mbrojtjes ligjore e trajnerëve dhe sportistëve...</p> <p>Nxënësi që numëron një ose dy shkaqe, merr <b>1 pikë</b>. Nxënësi që numëron më shumë se dy shkaqe, merr <b>2 pikë</b>. <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 3 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>4.</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <p>- tregon për marrëdhëniet e tifozëve (grupeve të tifozëve) ndaj tifozëve të tjerë, duke dhënë shembuj nga përvoja e vet ose nga mediat (p.sh. fillimi i rrahjes, shkatërrimi i murit mbrojtës, djegia e ulëseve, hedhja e shisheve, topave të letrës...) <b>– 1 pikë</b></p> <p>- tregon për marrëdhëniet e tifozëve (grupeve të tifozëve) ndaj sportistëve, arbitrave, kalimtarëve... duke dhënë shembuj nga mediat ose nga përvoja e vet (p.sh. gjendjet e padëshirueshme barten shpesh jashtë terrenit, kështu që përveç sportistëve, arbitrave dhe trajnerëve, e pësojnë edhe kalimtarët, e gjuajnë me gurë autobusin, vitrinat e shitoreve...) <b>– 1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>5.</b></p>	<p>Nxënësi :</p> <p>- thotë se dhuna në sport është, gjegjësisht nuk është model si duhet të sillen të rinjtë, duke dhënë argumentin adekuat. <b>– 1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>6.</b></p>	<p>Nxënësi :</p> <p>- tregon çfarë pasojash rrjedhin nga sjellja e dhunshme e tifozëve ose grupeve të tifozëve: prishja e qetësisë dhe rendit publik, viktima mund të jenë tifozët, fëmijët, sportistët, huliganët shkatërrojnë qytetin, thyejnë autobusë... <b>– 1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr 1 pikë</i></p>

	<b>Gjithsej 2 pikë</b>
<b>Kërkesa</b> <b>7.</b>	<p>Nxënësi :</p> <p>- jep propozime si mund të parandalohet vandalizmi dhe huliganizmi në ngjarjet sportive (p.sh. përmes një kontrolli më të rreptë në hyrje dhe dënimeve të rrepta, ndalimin e futjes së alkoolit, flamujve dhe transparenteve me përmbajtje fyese, duke i publikuar në internet fotografitë e tifozëve – huliganëve, si në Poloni, përmes edukimit të tifozëve nga klubet sportive, shkollat, bashkësitë lokale, mediat; transporti i tifozëve miq të organizohet më mirë; të bëhet ndërgjegjësimi i grupit të tifozëve përmes shkrimeve në tabela (bilborde), karta, pllakate, këmisha; duke firmuar ueb faqe dhe grupe fejsbuku...</p> <p>Nxënësi që numëron vetëm një ose dy shembuj, të cilat i ka përmendur diku në ese, merr <b>1 pikë</b>.</p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil, merr <b>1 pikë</b></i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>

### Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil	respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, foljet përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b> , përemrit <b>i vet/ i tij</b> , përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i	lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve  <b>1 pikë</b>	përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)  <b>2 pikë</b>
<b>3 pikë</b>			

<p>originaliteti (interpretion me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të</p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>,</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda</p>

<p>shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		<p>shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>
---	--	--	---